

KOMUNIKATË PËR UEB

Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), TM2 2024

27.03.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e dytë (TM2) 2024.

Mbetet e njëjtë shkalla e papunësisë në Kosovë (10,7%) në TM2 2024, krahasuar me TM2 2023

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 074 704) janë popullsi në moshë pune (85 960 më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Persona aktivë ishin 461 675 (8 862 më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).
Persona joaktivë ishin 613 029 (87 536 më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).
Persona të punësuar ishin 412 482 (7 668 më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).
Persona të papunësuar ishin 49 194 (1 193 më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Tabela 1. Treguesit kryesorë të tregut të punës TM2 2024 / TM2 2023

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	TM2 2024			TM2 2023		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	327092	134583	461675	325114	145423	470537
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	210182	402847	613029	243115	457 450	700565
Të punësuar (15-64 vjeç)	300454	112028	412482	301861	118 289	420150
Të papunësuar (15-64 vjeç)	26638	22556	49194	23 253	27 134	50387
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	7981	6138	14119	5 692	5 305	10 997
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	39879	38578	78457	48 810	49 207	98 017
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	52582	8698	61280	52 788	9 629	62 417
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	60.9	25.0	43.0	57.2	24.1	40.2
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	39.1	75.0	57.0	42.8	75.9	59.8
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	55.9	20.8	38.4	53.1	19.6	35.9
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	8.1	16.8	10.7	7.2	18.7	10.7
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	18.3	26.7	21.2	12.6	23.4	16.2
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	29.9	30.8	30.3	33.0	33.5	33.3
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	17.5	7.8	14.9	17.5	8.1	14.9

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 55,9% (2,8% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Kurse përqindja e femrave të punësuar ishte 20,8% (1,2% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Shkalla e punësimit ishte 38,4% (2,5% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Shkalla e papunësisë ishte 10,7%, identike sikurse në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Kurse tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte 21,2% (5,0% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë (57,0 %), mirëpo vërehet një rënie e përqindjes (-2,8%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar (75,0%), krahasuar me meshkujt (39,1%).

Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimit prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 20,2%, ndërtimtaria 11,9%, prodhimi me 11,4%, arsimit me 9,2%, administrata publike dhe mbrojtja me 7,9%, etj.

Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e tregtisë, arsimit dhe kujdesit shëndetësor me 51,2% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit me 47,5%.

Tabela 2. Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktiviteteve ekonomike në TM2 2024, moshë 15+

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	3.5	0.8	2.8
B - Minierat dhe xehoret	1.6	0.1	1.2
C - Prodhimi	12.1	9.6	11.4
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.2	0.3	1.7
E - Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.7	0.2	1.3
F - Ndërtimtari	16.0	0.9	11.9
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe motoçikletash	19.4	22.1	20.2
I - Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.9	5.6	7.3
H - Transport dhe depozitim	3.7	1.9	3.2
J - Informim dhe komunikim	2.7	2.4	2.6
K - Aktivitete financiare dhe sigurimesh	2.1	4.4	2.7
L - Aktivitete me prona të paluajtshme	0.3	0.0	0.2
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.8	3.4	3.0
N - Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.6	6.1	4.3
O - Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	8.3	6.6	7.9
P - Arsimit	6.1	17.7	9.2
Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	2.3	11.4	4.8
R - Arti, zbavitja dhe rekreacioni	0.7	0.9	0.8
S - Aktivitete të shërbimeve të tjera	1.9	3.3	2.3
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0.1	0.5	0.2
U - Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.8	1.8	1.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore. Për realizimin e AFP-së, TM2 2024, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM2 2024 vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/LaborMarket>